



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 324/17 Prot.

Pogradec, më 02 .02 .2026

VENDIM

Nr. 08 , datë 29 .01 .2026

**PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE Z. PERPARIM
BESHELLO, GURAS, N.J.A. BUÇIMAS, BASHKIA POGRADEC, PËR
SHKAK TE DMTIMIT TE BANESES NGA RENIA E ZJARRIT**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të pikës 1 të nenit 29, të ligjit nr. 139/2015, "Për Veteqeverisjen Vendore", të neneve 4, 7 dhe 41, të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile" dhe të kapitullit III të V.K.M Nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerezore", me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Pogradec për mbështetje financiare të z Perparim Beshello për dëmtimin e banesës nga rënia e zjarrit në datën 10.12.2025.
 2. Miratimin e dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Pogradec.
 3. Ti akordojë familjes së shtetasit Perparim Beshello ndihmën emergjente në vlerën prej **159 466 Lek.**
- nga buxheti i Bashkisë Pogradec, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec për vitin 2026.



4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile, Strehimi, Shpronësimeve, Titujve të Pronësise, Administrimit të Tokës bujqësore, Sherbimeve, si dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare të Bashkisë Pogradec.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes:

KRYETARE E KËSHILLI

Manjola KAMOLLI

1.Miratuar me 24 vota

2.Vota Pro 24

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 29.01.2026

